


Drafti i 2-të i udhëzimeve për procesin e PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DETAR në Shqipëri



Prepared by

MSP cycle



The Mediterranean
Biodiversity
Centre



MINISTERO DELL'AMBIENTE
E DELLA TUTELA DEL TERRITORIO E DEL MARE



Tiranë, Dhjetor 2019

Lista e akronimeve

AFDW	Pesha në të thatë dhe pa përmbajtje karboni
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BE	Bashkimi Evropian
CBD	Konventa për Shumëllojshmërinë Biologjike
GEF	Fondi Global i Mjedisit
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
ICZM	Menaxhimi i Integruar i Zonave Bregdetare
KE	Komisioni Evropian
NIS	Lloje jo vendase
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSPAR	Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Verilindor
PHD	Planifikimi Hapësinor Detar.
PMVI/DKSD	Programi i Monitorimit dhe Vlerësimit të Integruar / Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare
PSSA	Zonat Detare me Ndjeshmëri të Veçantë
TDS	Lënga e Ngurtë e tretur Totale
TPEA	Planifikimi Ndërkufitar në Atlantikun Evropian
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
Udhëzime kontekstuale për PHD-në	7
UDHËZIME PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DETAR NË SHQIPËRI	8
1. Mbledhja e të dhënave për tema të ndryshme	8
2. Organizimi dhe disponueshmëria e të dhënave	11
3. Planifikimi dhe menaxhimi hapësinor detar	13
4. Zbatimi i PHD-së (mekanizëm i vazhdueshëm)	17

PARATHËNIE

Shpesh, planifikimi i përdorimit të tokës dhe planifikimi hapësinor detar (PHD) konsiderohen si dy instrumente të ndryshme. Në konceptin e Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare (ICZM), ato janë të dythelbësorë dhe ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin.

Në kuadër të Protokollit për ICZM-së në Mesdhe, planifikimi hapësinor i zonave bregdetare konsiderohet si një instrument thelbësor për zbatimin e tij, siç citohet më poshtë.

Një nga objektivat kryesorë të ICZM-së është *“të lehtësojë, përmes planifikimit të arsyetuar të aktiviteteve, zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare duke garantuar që mjedisi dhe peizazhet të merren në konsideratë në mënyrë të harmonizuar me zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor”* (neni 5). Planifikimi përmendet gjithashtu edhe në nene të tjera të këtij protokollit, p.sh. në ato që trajtojnë mbrojtjen e ligatinave, estuareve dhe habitateve detare (neni 10) ose mbrojtjen e peizazhit bregdetar (neni 11).

Udhëzimet vijuese janë hartuar duke marrë në konsideratë dhe grupet e ndryshme të interesit dhe dëgjuesve të cilave ato u drejtohen si dhe objektivat e tyre të ndryshme:

Për planifikuesin dhe administratorin

Garantimi i vazhdimësisë së planifikimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të të gjitha veprimtarive dhe ndikimeve të mundshme natyrore ose njerëzore si dhe midis mjedisit tokësor dhe detar të zonës përkatëse.

Për administratorin dhe kontrollorin

Zhvillimi i një kadastrë të ujërave detare të ngjashme me atë tokësore dhe marrja në konsideratë, me kalimin e kohës, e të paktën tre dimensioneve për mjedisin detar: sipërfaqja e detit, kolona e ujit dhe shtrati i detit (mund të merren në konsideratë edhe dy të tjera, hapësira ajrore mbi sipërfaqe dhe nëntoka poshtë shtratit).

Për komunitetet dhe grupet e interesit

Garantimi i koherencës midis të gjitha veprimtarive në mjedisin tokësor dhe detar me qëllim respektimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e ekosistemeve, llojeve dhe proceseve biologjike ekzistuese, si dhe sigurimin e një mjedisi të ekuilibruar e të harmonizuar socio-ekonomik për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë të zonës.

Në vijim renditen parimet e përbashkëta thelbësore që duhet të merren në konsideratë gjatë PHD-së:

- Planifikimi dhe menaxhimi përshtatës: për shkak të pasigurive gjatë përcaktimit të një sistemi planifikues ose menaxhues, në veçanti në kuadër të ndërveprimit të mjedisit detar dhe tokësor, në lidhje me çështjet natyrore, ekologjike, sociale apo ekonomike, ose për shkak të rasteve të emergjencave, planifikimi dhe menaxhimi duhet të mund të përshtaten dhe të reagojnë menjëherë ndaj situatave të reja.
- Qasja e bazuar në ekosistem: për Konventën për Shumëlloshmërinë Biologjike (CBD), qasja e bazuar në ekosistem përbën një strategji të menaxhimit të integruar të tokave, ujërave dhe burimeve biologjike e cila nxit ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm e të paanshëm. Ajo bazohet mbi zbatimin e metodologjive të përshtatshme shkencore të cilat fokusohen në nivelet e organizimit biologjik që përfshijnë proceset, funksionet dhe ndërveprimet thelbësore midis organizmave dhe mjedisit të tyre. Gjithashtu, ajo merr në konsideratë se njerëzit, me diversitetin e tyre kulturor, janë një pjesë përbërëse e ekosistemeve.
- Transparenca (e të dhënave dhe proceseve): përbën një instrument thelbësor për një qeverisje mjedisore efikase dhe veçanërisht për pjesëmarrjen dhe aksesin e publikut në informacion.
- Pjesëmarrja e plotë: Konventa e Aarhusit për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (ku bën pjesë edhe Shqipëria) garanton shtimin e mundësive të aksesit të qytetarëve në informacion si dhe një procedurë rregullatore të besueshme e transparente. Kjo përbën një mënyrë për fuqizimin e rrjetit të qeverisjes mjedisore, duke prezantuar një marrëdhënie ndërvepruese dhe të besueshme midis shoqërisë civile dhe qeverive.
- Qasja e integruar (të gjithë sektorët, toka dhe deti): për menaxhimin e burimeve detare dhe bregdetare, planifikuesit duhet të marrin në konsideratë metoda menaxhimi shumëpërdorimëshe dhe të orientuara drejt sistemeve, në bazë të qasjeve parandaluese dhe parimeve të menaxhimit të ekosistemeve.
- Ndërvarësia: qasja e integruar duhet të marri në konsideratë ndërvarësinë (natyrore, sociale, ekonomike) midis mjedisve detare dhe atyre tokësore me qëllim garantimin e një menaxhimi efikas dhe të qëndrueshëm;
- Qasja në nivele të shumfishta: çdo lloj planifikimi dhe menaxhimi duhet të marri në konsideratë kontekstet ndërkombëtare, kombëtare, nënrajonale dhe lokale për përcaktimin e kufizimeve dhe modaliteteve të zbatimit.
- Dimensionet e shumfishta, duke përfshirë periudhën kohore: toka konsiderohet zakonisht në bazë të tre përbërësve kryesorë që janë hapësira ajrore, sipërfaqja dhe nëntoka, ndërsa mjedisi detar është më kompleks dhe përbëhet nga hapësira ajrore, sipërfaqja e ujit, kolona e ujit, tabani i detit dhe nëntoka. Në të dyja rastet, koha është një faktor shtesë për t'u marrë parasysh.
- Monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i përhershëm: duhet të ngrihet një sistem i qëndrueshëm monitorimi me qëllim ndjekjen e ecurisë së parametrave natyrorë, socialë dhe ekonomikë,



e që të mundësojë vlerësimin e rreziqeve dhe propozimin e treguesve dhe mekanizmeve të sinjalizimit për ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të masave të planifikimit dhe menaxhimit;

— Vlerësimi strategjik mjedisor i planit të propozuar: VSM është një proces sistematik për mbështetjen e vendimmarrjes i cili synon të garantojë që aspekti mjedisor dhe aspektet e tjera të qëndrueshmërisë të merren në konsideratë sa më me efikasitet gjatë hartimit të politikave, programeve, planifikimit dhe menaxhimit. Ai duhet të zbatohet rregullisht për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të procesit, veçanërisht në rast të programimit të aktiviteteve të reja në fushën e PHD-së.

Përfitimet kryesore të identifikuara të PHD-së janë:

- Qartësimi i roleve dhe funksioneve të mjedisit detar;
- Përmirësimi i bashkërendimit midis organeve administrative dhe sektorëve ekonomik;
- Zbutja e konflikteve;
- Saktësimi i të drejtave dhe rregullave për të gjitha palët;
- Rritja e njohurive dhe pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit;
- Rritja e transparencës për sa u përket rregullave dhe kufizimeve të investimeve;
- Përmirësimi i mbrojtjes/ruajtjes së aseteve natyrore dhe kulturore në favor të të gjitha palëve;
- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit;
- Të tjera aspekte.

Udhëzime kontekstuale për PHD-në

Këto udhëzime janë përgatitur për Shqipërinë në kuadër të PMVI-së, Protokollit të ICZM-së dhe Vendimit për PHD-në (Vendimi “Për kuadrin konceptual të PHD-së”).

Vendimet e Palëve Kontraktuese (Vendimi IG.17 / 6 “Për zbatimin e qasjes së bazuar në ekosistem për menaxhimin e veprimtarive njerëzore që mund të ndikojnë në mjedisin detar dhe bregdetar të Mesdheut” dhe Vendimi IG.20 / 4 “Për zbatimin e udhërrëfyesit të qasjes së bazuar në ekosistem”) pasqyrojnë dëshirën për të konsoliduar bashkëpunimin dhe për të kërkuar sinergji me iniciativën DKSD të BE-së, me qëllim arritjen e vizionit të përbashkët “një Mesdhe i shëndetshëm me ekosisteme detare dhe biologjike produktive dhe biologjikisht të shumëllojshme në favor të brezave të sotëm dhe të ardhshëm”.

Gjithashtu, Planifikimi Hapësinor Detar (PHD) bazohet në ndarjen e hapësirës detare me qëllim mundësimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, duke përfshirë mbrojtjen e biodiversitetit detar dhe ruajtjen e burimeve detare, si dhe arritjen e objektivave socio-ekonomike, duke lënë pas qasjen e bazuar në një sektor të vetëm e cila fokusohet në një përdorim të caktuar të detit.

Sipas Komisionit Evropian (KE), PHD përmbush katër objektiva:

- Reduktimin e konflikteve për aksesin në hapësirën detare;
- Reduktimin e ndikimeve kumulative të veprimtarive detare në mjedis;
- Reduktimin e kostove të bashkërendimit për autoritetet publike; dhe
- Rritjen e sigurisë dhe parashikueshmërisë për investimet private.

Në Detin Adriatik, zbatimi i qasjes së bazuar në ekosistem dhe rritja e kapacitetit të menaxhimit nënrajonat përmes PHD-së synojnë rikuperimin e ekuilibrit të tij.

UDHËZIME PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DETAR NË SHQIPËRI

Në vijim parashtrohet një udhëzim progresiv për zbatimin e PHD-së në Shqipëri:

1. Mbledhja e të dhënave për tema të ndryshme

Mbledhja e të dhënave është thelbësore, pasi ajo shërben për ta zbritur procesin në kontekstet ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale. Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë elementeve në vijim:

- Legjislacionit dhe institucioneve të menaxhimit, planifikimit dhe zbatimit të ICZM-së, VSM-së dhe VNM-së në nivelet përkatëse (ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale)

- Politikat dhe strategjitë ekzistuese dhe të planifikuara në nivele kombëtare, rajonale dhe vendor

- Legjislacionit, institucioneve të ICZM-së dhe PHD-së

- Identifikimit të grupeve të interesit

- Kërkimit, monitorimit, ekspertizës në nivel kombëtar dhe vendor

- Të dhënave të zonës në të gjithë sektorët përkatës (natyrorë, kulturorë, socialë dhe ekonomikë)

- Identifikimit paraprak të zonave që konsiderohen si të cenueshme, me rëndësi, të prekura ose që kanë nevojë për rehabilitim

- Ndikimeve të mundshme nga ndryshimet klimatike

- Identifikimit të mangësive në njohuri, studime dhe monitorim

- Zhvillimit të programeve kërkimore plotësuese me qëllim reduktimin e këtyre mangësive

- Përcaktimit të treguesve dhe ngritjes së sistemeve të qëndrueshme të monitorimit dhe vlerësimit

- Marrjes në konsideratë të qasjeve novatore për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Seksioni 1 në lidhje me të dhënat natyrore që duhen mbledhur

Të dhënat dhe informacionet e mëposhtme janë të domosdoshme për procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes

Kushtet meteorologjike dhe lokale

- Reshjet, erërat, temperaturat...
- Parametrat detarë: baticat, dallgët, rrymat...
- Tiparet gjeologjike, sedimentologjike, gjeomorfologjike, tektonike
- Të tjera, në bazë të zonave të veçanta.

Biodiversiteti

- Shumëllojshmëria e komuniteteve,
- Shumëllojshmëria/ndjeshmëria e habitateve,
- Humbja e biodiversitetit të habitateve dhe komuniteteve,
- Vdekshmëria aksidentale,
- Llojet e rrezikuara, në rrezik zhdukjeje dhe ato të cenueshme,
- Llojet invazive,
- Llojet jo vendase,
- Integriteti gjenetik,
- Llojet karizmatike
- Zonat kritike për biodiversitetin
- Të tjera, në bazë të zonave të veçanta.

Prodhimtaria

- Prodhimtaria parësore dhe dytësore,
- Struktura trofike,
- Prodhimtaria e popullatës,
- Llojet detare
- Statusi dhe shfrytëzimi i popullatave,
- Të tjera, në bazë të zonave të veçanta.

Cilësia dhe ndikimet në mjedisin detar

- Karakteristikat fizike
- Karakteristikat kimike
- TDS dhe karakteristikat e lëndës organike
- Habitati
- Zhurmat
- Mbetjet dhe mbeturinat
- Ndotja e ujit
- Ndotja nga sedimentet
- Ndotja atmosferike
- Ekotoksikologjia
- Sforco e peshkimit

Draft-udhëzime për përdikimet e akuakulturës dhe marikulturës SPA/RAC në Shqipëri

- Ndikimet e trafikut detar dhe porteve
- Të tjera, në bazë të zonave të veçanta.

Seksioni 2 në lidhje me sektorët përkatës të veprimtarive njerëzore që duhet të merren në konsideratë

- Peshkimi: peshkimi tregtar artizanal dhe industrial, çlodhës dhe sportiv.
- Akuakultura dhe marikultura,
- Transporti detar: mallra, pasagjerë, naftë dhe gaz,
- Rrugët dhe sinjalistika detare,
- Kërkimi dhe shfrytëzimi i naftës dhe gazit,
- Prodhimi i energjisë (burimet e energjisë eolike, energjisë së valëve të detit, energjisë alternative dhe ekologjike...),
- Veprimtaritë minerare (rërë, zall, minerale...),
- Pastrimi i shtretërve nga sedimentet (dragat),
- Eliminimi i sedimenteve të mbledhura ,
- Pompimi dhe shkarkimi në det (ujërat e përodrura dhe të shirave, ftohja, shkripëzimi, ...),
- Kabllot dhe tubacionet,
- Strukturat në det të hapur,
- Veprimtaritë çlodhëse në det dhe pranë bregut,
- Mjetet private të lundrimit,
- Zonat e ruajtjes për burimet natyrore, peizazhet detare,
- Sitet kulturore (përdorim tradicional, rrënoja anijesh, site arkeologjike...),
- Veprimtaritë ushtarake, zonat e kufizuara,
- Kërkimet shkencore dhe kërkimi dhe zhvillimi i burimeve të reja biologjike,
- Veprimtaritë njerëzore të jashtëligjshme si peshkimi i jashtëligjshëm
- Ndërtimi i jashtëligjshëm në bregdet,
- Shfrytëzimi i jashtëligjshëm i bregdetit, si shfrytëzimi i jashtëligjshëm i rërës në bregdet, mbetjet/produktet kimike të jashtëligjshme
- Të tjera, në bazë të zonave të veçanta

2. Organizimi dhe disponueshmëria e të dhënave

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) është një sistem i krijuar për regjistrimin, ruajtjen, modifikimin, analizimin, menaxhimin dhe paraqitjen e të dhënave gjeografike dhe hapësinore. Aplikacionet e GIS janë mjete që u mundësojnë përdoruesve të krijojnë pyetësorë ndërveprues, të analizojnë të dhënat hapësinore, të modifikojnë të dhënat në harta, të analizojnë çdo veprimtari në mënyrë të veçantë dhe kumulative për të vlerësuar ndikimet e tyre dhe konfliktet midis veprimtarive si dhe të identifikojnë zgjidhje për zhvillimet aktuale dhe të ardhshme duke ruajtur cilësinë dhe produktivitetin e mjedisit. Për qëllimin e fushës së studimit, duhet të merren në konsideratë elemente të ndryshme si më poshtë:

- Zhvillimi i një sistemi SIG për hartëzimin e veprimtarive
- Krijimi i një platforme pa pagesë për zonën (ku të përfshihen hartat, referencat, analizat, konfliktet, grupet e interesit etj.) për transparencë dhe pjesëmarrje
- Paraqitja e një analize për përdorimin aktual të mjedisit detar dhe për ndërveprimet ndërmjet përdorimit të tokës dhe detit
- Paraqitja e një analize për kushtet, statusin dhe cilësinë aktuale të mjedisit detar
- Paraqitja e një analize për ndikimet kumulative
- Paraqitja e një analize për konfliktet dhe pajtueshmërinë midis veprimtarive të ndryshme
- Identifikimi i rreziqeve kur merren në konsideratë veprimtari të reja,
- Identifikimi i skenarëve të ardhshëm, përzgjedhja e më të përshtatshmit sipas zonave ose nënzonave, zhvillimi i planifikimit, identifikimi i treguesve dhe i një sistemi për ndjekjen dhe vlerësimin afatgjatë të planit dhe modifikimeve të tij të nevojshme.

Seksioni 3 Model udhëzimi: SISTEMI INFOMAP është platforma e OKB-së për njohuritë mbi Mesdheun, e krijuar për sigurimin dhe shkëmbimin e të dhënave, shërbimeve informative dhe njohurive në favor të elementeve përbërëse të Planit të Veprimit për Mesdheun dhe Palëve Kontraktuese. Ai mundet gjithashtu të mbështesë Statusin e Cilësisë së Mjedisit në Mesdhe dhe Raportin e Gjendjes së Mjedisit. Qëllimi i tij është:

- Garantimi i aksesit në sistemin e raportimit;
 - Harmonizimi i strukturave dhe modeleve të të dhënave;
 - Krijimi i një katalogu të përbashkët burimor;
 - Integrimi i të dhënave me shtresën e ndërveprueshmërisë;
 - Krijimi i një platforme të përbashkët për paraqitjen, diskutimin dhe analizën e të dhënave;
 - Krijimi i mekanizmave për mbështetjen e përhapjes së të dhënave dhe informacioneve.
- <http://www.info-rac.org/en/infomap-system>

Seksioni 4 në lidhje me grupet e interesit

Analiza e grupeve të interesit duhet të sigurojë të dhëna të përgjithshme dhe të detajuara për të gjithë aktorët në nivel kombëtar, rajonal, ndërkombëtar, duke specifikuar interesat e tyre në zonat dhe nënzonat përkatëse si dhe mënyrat më të mira të pjesëmarrjes së tyre në të gjitha proceset. Më poshtë paraqiten kategoritë kryesore të grupeve të interesit, ndërsa në raportin teknik bashkëngjitur këtyre udhëzimeve jepen të dhëna të detajuara:

- Organet administrative (kombëtare dhe lokale që përfshijnë ministritë e linjës dhe agjencitë përkatëse si AKZM, AKM etj.),
- Universitetet dhe institutet kërkimore shkencore,
- Shoqëritë shtetërore,
- Shoqëritë private,
- Fondacionet,
- OJQ-të,
- Qytetarët,
- Të tjera, sipas rastit, në bazë të zonave të veçanta.

3. Planifikimi dhe menaxhimi hapësinor detar

Kjo është padyshim faza më e rëndësishme e procesit, pasi në të përcaktohen vizioni dhe objektivat strategjikë për të ardhmen. Në bazë të të gjitha të dhënave të grumbulluara dhe skenarëve të ndryshëm të marrë në konsideratë të gjitha grupet e interesit do të duhet të zgjedhin një alternativë dhe të përcaktojnë veprimtaritë, masat e menaxhimit, sistemet e kontrollit dhe të zbatimit, kuadrin e monitorimit, kuadrin e vlerësimit dhe periudhën e zbatimit të prioriteteve. Për më tepër, monitorimi dhe përcaktimi i treguesve do të mundësojë ngritjen e mekanizmave të sinjalizimit, përcaktimin e nevojës për modifikime dhe ndryshimin, kur është nevoja, të zonimit dhe rregullave përkatëse të çdo veprimtarie,


Elementet kryesore që duhet të merren në konsideratë gjatë kësaj faze janë si më poshtë:

- Domosdoshmëria e procesit përfshirës
- Krijimi i një vizioni që përcakton objektivat afatgjata të përdorimit të detit, vijës bregdetare dhe zonës ujëmbledhëse bregdetare
- Drafti i parë i PHD-së (zonimi shumëdimensional, programimi kohor, kadastra e ujërave detare, ...)
- Kryerja e një vlerësimi strategjik mjedisor për draftin e propozuar të PHD-së
- Periudha e propozuar për zbatimin
- Mekanizmat monitorues, vlerësues dhe rregullues
- Situatat e emergjencës (ndotje, tsunami...)

Seksioni 5: Mekanizmat e domosdoshëm të planifikimit hapësinor detar gjatë procesit

- Planet e menaxhimit të përdorimit të detit
- Kadastra e ujërave detare
- Hartat dhe rregulloret e zonimit
- Planet e zonave
- Planet e investimit për infrastrukturën
- Zonat e veçanta të menaxhimit
- Rregulloret
- Sistemet e mbikëqyrjes dhe zbatimit (gjoba të përshtatshme dhe pezullime të lejeve apo koncesioneve)
- Standardet për llojet, ujërat dhe sedimentet
- Lejet dhe koncesionet për veprimtaritë njerëzore
- Instrumentet ekonomike lidhur me lejet dhe koncesionet, krijimi i një fondi për PHD-në
- Organet administrative, krijimi i një agjencie të posaçme
- Hartimi i udhëzimeve për praktikatat më të mira mjedisore/kodet e praktikave ose të sjelljes
- Programet e monitorimit
- Rrjeti i asistencës teknike
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi
- Platforma informative
- Fuqizimi dhe përfshirja e brezave të rinj në sektorin e turizmit blu dhe të gjelbër
- Trajnimet dhe rritja e kapaciteteve

Seksioni 6: Model i dy planifikimeve të ndryshme të trafikut detar në ngushticën e Sazanit, gjiri i Vlorës, Shqipëri - Marrë nga “SEMINARI I RAJONIT TË ADRIATIKUT PËR PSSA-të”, organizuar në Tiranë, më 10-13 dhjetor 2019.




Plani ekzistues: trafiku detar përgjatë ngushticës

Trafiku detar jashtë ngushticës

Seksioni 7 në lidhje me qasjen përfshirëse

Konventa për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (Aarhus, 1998) është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2000. Konventa përshkruan mekanizmat e nevojshëm për realizimin e pjesëmarrjes së duhur të bazuar në transparencë dhe aksesit në informacion për të gjithë pjesëmarrësit.

In MSP, the term 'stakeholder' refers to *any individual, group, or organisation that are or will be affected, involved or interested (positively or negatively)* and can be classified into the following three broad categories:



- Government decision-makers at various levels (i.e. government stakeholders including ministries, state agencies, municipalities and local government);
- Commercial or industry stakeholders representing the key marine sectors operating in the area;
- Civil-society stakeholders represented by the research community, citizen and community-based organisations, non-governmental organisations (NGOs), and conservation groups.

Fig 1 Grupet e interesit të PHD-së: Ilustrimi skematik vazhdon në pjesën 4.

Seksioni 8: Nevoja për monitorim (në përputhje me PMVI/DKSD)

- Kushtet meteorologjike
- Monitorimi i kimikateve në ujin e detit (me transekte në gjatësinë dhe gjerësinë e bregdetit)
- Monitorimi i rrymave, baticave dhe dallgëve
- Përmbajtja organike aloktone dhe autoktone e tabanit të detit (AFDW) dhe protokolli biokimik)
- Përmbajtja organike aloktone dhe autoktone (AFDW) e ujit të detit/florës detare (AFDW dhe protokolli biokimik)
- Eutrofikimi – Klorofila -A - përqendrimi në kolonën e ujit dhe sedimentet ujore
- Eutrofikimi - përqendrimi i lëndëve ushqyese kryesore në kolonën e ujit dhe sedimentet ujore
- Monitorimi i komuniteteve detare bentike (fundet ranore detare)
- Monitorimi i komuniteteve detare bentike (fundet shkëmbore detare)
- Vlerësimi, hartëzimi dhe monitorimi i livadheve të florës detare
- Monitorimi i *Posidonia oceanica* dhe algave të detit si Cystoseiraceae (treguesi CARLIT etj.)
- Fushatat e monitorimit të llojeve jo vendase dhe atyre invazive
- Censusi i llojeve karizmatike (gjitarët, zogjtë dhe zvarranikët detarët...)
- Protokolli i monitorimit të censusit vizual të popullatave të peshqve
- Vlerësimi i popullatave të peshqve fundorë

Seksioni 9: Model udhëzimi: linku i faqes së internetit të FGM_Programet e vlerësimit dhe monitorimit të GAP në Adriatik:

https://drive.google.com/drive/folders/1fC5bWLstP_25kLYVANQcyywohlsib_ba

Jep udhëzime të plota që duhen ndjekur për qëllimet e monitorimit të mjedisit detar, duke marrë në konsideratë se disa nga këto udhëzime janë miratuar nga qeveria.

4. Zbatimi i PHD-së (mekanizëm i vazhdueshëm)

Pas ndërmarrjes së të gjithë hapave të mëparshëm dhe pas miratimit të planit, nis periudha e zbatimit që është një proces i vazhdueshëm dhe që përfshin një monitorim dhe vlerësim të rregullt e të herëpashershëm. Zbatimi dhe administrimi, që realizohen më mirë në nivel lokal (struktura rajonale ose lokale), do të kryhen nga një ekip profesionistësh ku bëjnë pjesë ekspertë të fushave ligjore, institucionale, shkencore, sociale, ekonomike dhe të komunikimit, nën mbikëqyrjen e një bordi i cili përfshin përfaqësues të ministrive dhe organeve administrative kompetente kryesore.




Fig. 2. Fazat e ciklit të PHD-së që ilustrojnë se si pjesëmarrja e grupeve të interesit ka kontribuar në të gjithë procesin e projektit TPEA. (SW=Seminar me grupet e interesit) (Twomey dhe O'Mahony, 2014)

Elementet kryesore të zbatimit renditen në vijim:


- Ngritja e një mekanizmi të përhershëm pjesëmarrjeje;
- Identifikimi i objektivave të planifikimit dhe menaxhimit të lidhura me vizionin strategjik;
- Identifikimi i ekipit/institucionit menaxhues për zbatimin dhe ndjekjen e mëtejshme;
- Identifikimi i mekanizmave/kuadrove ligjore dhe institucionale për zbatimin dhe ndjekjen e mëtejshme;
- Hartëzimi dhe përvijimi fizik i zonimit të veprimtarive në mjedisin detar;
- Përcaktimi i rregulloreve për çdo zonë;
- Komunikimi dhe ndërgjegjësimi mbi planin dhe masat menaxhuese;
- Periudha kohore dhe buxheti (3 deri në 5 vite sipas përcaktimit në doracakun e PHD-së);
- Ngritja e një sistemi gjithëpërfshirës monitorimi (natyror, kulturor, social dhe ekonomik) në përputhje me PMVI/DKSD; (shpeshësia do të përcaktohet në doracakun e PHD-së)
- Vlerësimi (financiarisht çdo vit, zbatimi çdo 3 deri në 5 vite sipas përcaktimit në doracakun e PHD-së);
- Rishikimi i PHD-së (çdo 3 deri në 5 vite dhe atëherë kur konsiderohet e përshtatshme në përputhje me ngjarje të veçanta apo ndryshime në përdorimin e detit, gjë që do të përcaktohet në doracakun e PHD-së).

Më poshtë paraqitet një ilustrim i kombinuar i udhëzimeve për pjesëmarrjen e grupeve të interesit të PHD-së

Tabela 1 Lista e instrumenteve kryesore ndërkombëtare dhe evropiane me rëndësi për Atlantikun evropian, të cilat kërkojnë pjesëmarrjen e grupeve të interesit.

TË BRENDSHME	BASHKIMI EVROPIAN
Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin (1992) dhe Axhenda 21	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Atlantikun
Konventa për Diversitetin Biologjik (CBD)	Direktiva 2014/89/BE “Për Planifikimin hapësinor detar”
Konventa OSPAR dhe Strategjia për Mjedisin e Atlantikut Verilindor	Direktiva 2003/4/KE “Për aksesin e publikut në informacionet mjedisore”
Konventa e Aarhus	Direktiva 2003/35/BE “Për pjesëmarrjen e publikut”

Fig.3 Vazhdimësia e pjesëmarrjes së grupeve të interesit (duke përdorur kategoritë e industrisë, shoqërisë civile dhe qeverisë - kjo e fundit mund të përfshijë nivele të ndryshme autoriteti nga ai vendor e rajonal deri te ai kombëtar) në PHD-në në Evropë, me faza të ndryshme nga sigurimi i informacionit deri te bashkëpunimi midis të gjitha kategorive të grupeve të interesit. Shigjetat përfaqësojnë fluksin e informacionit dhe orientimin e ndërveprimeve midis grupeve të interesit.



- Nxit përvetësimin e planit, rrit besimin midis grupeve të interesit dhe vendimmarrësve si dhe zbatimin e vullnetshëm të rregullave dhe rregulloreve.
- Përmirëson kuptimin e kompleksitetit (hapësinor dhe kohor) dhe të ndikimit të njeriut në fushën e menaxhimit të mjedisit detar.
- Nxit një arsyetim të përbashkët të problemeve dhe sfidave në fushën e menaxhimit.
- Rrit kuptimin e synimeve, perceptimeve dhe interesave bazë (shpesh të orientuara drejt një sektori) që nxisin dhe/ose ndalojnë integrimin e politikave në fushën e menaxhimit.
- Analizon pajtueshmërinë ekzistuese dhe të mundshme dhe/ose konfliktet midis objektivave të përdorimeve të shumëfishta të zonës së menaxhimit.
- Mbështet krijimin e alternativave, marrëveshjeve dhe zgjidhjeve të reja që mund të mos jenë marrë në konsideratë veçmas.
- Zgjeron dhe diversifikon kapacitetin e ekipit planifikues, veçanërisht nëpërmjet përfshirjes së informacioneve dytësore dhe tretësore (p.sh. njohuritë vendore dhe zakonet).

Tabela 2 Mekanizmat e pjesëmarrjes të propozuar nga grupet e interesit të TPEA-së dhe argumentet për përdorimin e tyre në proceset përfshirëse

Mekanizmi i pjesëmarrjes	Argumenti
Identifikimi i përkrahësve organizativë	Individët e përkushtuar që kanë akses në rrjetet gjithëpërfshirëse mund të mbështesin përpjekjet e ekipit të planifikimit
Përfshirja e politikanëve	Rrit besimin dhe mundëson diskutimet e thelluara
Përdorimi i mediave sociale	Twitter dhe LinkedIn janë format e reja të mediave që zgjidhen nga shumë profesionistë
Forumet e grupeve të interesit	Potencial për përfshirjen e grupeve të shumta të interesit
Fushatat publike	Instrumente për ndërgjegjësimin dhe nxitjen e përfshirjes
Takimet publike	U sigurojnë pjesëmarrësve një mënyrë përfaqësimi dhe një mundësi për të kontribuar, si dhe i lejon ekipit të planifikimit të mbulojë çdo aspekt teknik të planit
Vizualizimi (GIS/ simulimi i PHD-së/komunikimi dhe përkrahja) Forumet në internet	Mund të përbëjnë mjete novatore për nisjen dhe lehtësimin e diskutimeve Një mënyrë për publikimin e pyetjeve të shpeshta dhe media e preferuar e një numri të madh individësh
Udhërrëfyes/strategji angazhimi	Përkrahin vendin dhe mënyrën e përfshirjes së grupeve të interesit